



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:218826

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05481262

CP.nr.1063/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorëve V. T., G. A., A. M., Xh. Sh. R. H., I. Gj. – M., M. Sh., E. Q., H. Sh., te gjithë nga M. te cilët i përfaqëson me autorizim avokat Sheremet Ademi me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 516/2019, te datës 19.07.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 1063/21, te datës 09.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 20.03.2024 morri ketë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP 1063/21, me kreditor V. T., G. A., A. M., Xh. Sh. R. H., I. Gj. – M., M. Sh., E. Q., H. Sh., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit,” për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorët e përmbartimit V. T., G. A., A. M., Xh. Sh. R. H., I. Gj. – M., M. Sh., E. Q., H. Sh., te gjithë nga M. te cilët i përfaqëson me autorizim avokat Sheremet Ademi me seli ne Mitrovice, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 516/19, te datës 19.07.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP 1063/21, te datës 09.09.2021, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit”.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1063/21, te datës 09.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt, ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.1063/2021 më datë 20.03.2024

Gjyqtari

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimin të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.